

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit shpall 2 (dy) vende pune për personel ndihmësakademik në pozicionet “Specialist i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ALUMNI dhe Karrierës, si dhe “Specialist IT”:

A. Kandidatët për personel ndihmësakademik në pozicionin “Specialist i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ALUMNI dhe Karrierës” në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” në një program studimi të njëjtë me ato që ofrohen nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Master i Shkencave në Gjuhë Shqipe ose Master i Shkencave në Gjuhë Angleze;
2. Të njohë Kornizën Shqiptare të Kualifikimit dhe të ketë njohuri për procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë në kuadër të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit;
3. Të ketë njohuri për programet e studimit që ofron Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe aftësi informuese për nxënësit që kanë përfunduar studimet në ciklin e arsimit të mesëm në lidhje me programet e studimit që ofron fakulteti, kriteret e pranimi dhe politikat e institucionit;
4. Të jetë në gjendje të këshillojë studentët që diplomohen në ciklin e parë, mbi mundësinë e studimeve në një program të ciklit të dytë në FIN apo universitete të tjera jashtë vendit;
5. Të njohë tregun e punësimit të specialistëve që përfundojnë studimet në FIN dhe të mbajë lidhje të vazhdueshme me kompanitë e ndryshme brenda dhe jashtë vendit, duke analizuar kërkesat e tyre për punësim;
6. Të ketë mbrojtur një gjuhë të huaj të Bshkimit Europian. Gjuha angleze përbën përparësi.
7. Të njohë programet bazë të kompjuterit.

B. Kandidatët për personel ndihmësakademik në pozicionin “Specialist IT” në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” ose studimet sipas sistemit të vjetër:
 - Në një nga programet që ofron Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit të UPT-së;
 - Në programet e studimit Informatikë; Matematikë; Teknologji Informacioni, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të UT-së;
2. Të jetë i aftë të mirëmbajë rrjetin kompjuterik dhe telefonik të fakultetit, të instalojë dhe konfigurojë të gjitha pajisjet fundore të userave dhe aplikacionet në kompjuter;
3. Të jetë i aftë të konfigurojë pajisjet e rrjetit (Routers, switches etj), të mirëmbajë faqen /faqet e WEB të Fakultetit, si dhe e-mail-et përkatëse me këtë domain;
4. Të ketë mbrojtur një gjuhë të huaj të Bshkimit Europian. Gjuha angleze përbën përparësi.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë me shkrim për aplikim;
- Jetëshkrimi (CV);
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
- Fotokopje e diplomës universitare dhe listës së notave të noterizuara;
- Fotokopje e librezës së punës (në të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) e noterizuar;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, dëshmi e gjuhës së huaj etj. (nëse ka);
- Dëshmi e penalitetit ose formular vetëdeklarimi;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **25.05.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.